



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN 2024

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Istogut (KI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Istogut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Pagesat në vlerë 626,785€, sipas vendimeve gjyqësore përmbartimore për mbulimin e obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive për paga jubilarë dhe shujta, ishin paguar dhe regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate; dhe
- B2 Nënvlërim i pasurisë në vlerë 24,543€ si rezultat i mos regjistrimit në sistemin "e-pasuria" të pasurisë jo kapitale të blerë gjatë vitit 2024.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Istogut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në dy (2) raste, ishte bërë shfrytëzimi i pronave komunale me kontratë të skaduar;
- A2 Në dy (2) raste, kishte mangësi në procedurat e dhënies së subvencioneve; dhe
- B3 Në tre (3) raste, faturat në total prej 127,675€ kishte vonesa në pagesë deri në 30 ditë pas afatit të lejuar për pagesë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunes është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Istogut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Istogut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Istogut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Istogut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Komunës së Istogut.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet⁴

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, të cilat janë paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Kontrollat e brendshme sa i përket raportimit financiar duhet të përmirësohen dhe zbatohen tek klasifikimi i shpenzimeve në kategoritë përkatëse dhe raportimi i plotë i pasurive në PFV. Ndërsa, sa i përket çështjeve të pajtueshmërisë, duhet të përmirësohet procesi i pagesave me kohë të faturave dhe forcimi i kontrolleve në procesin e subvencionimit. Po ashtu, nevojiten kontrole më të shtuara edhe në çështjet tjera të menaxhimit si: menaxhimi i projekteve kapitale, menaxhimi i të arkëtueshmeve, procesi i dhënies në shfrytëzim të pronave komunale si dhe përmbushja e planit të NjAB-së. Këto gjetje dhe rekomandime kanë për qëllim të bëjnë korigjimin e nevojshëm të informacionit financiar të paraqitur në pasqyrat financiare, duke përfshirë shpalosjet në formë të shënimeve shpjeguese dhe të përmirësojnë kontrollat e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do t'i përcjellim (shqyrtojmë) këto rekomandime gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me 10 rekomandime, prej tyre katër (4) janë rekomandime të reja, pesë (5) të përsëritura dhe një (1) pjesërisht i përsëritur.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet që ndikojnë në opinionin e auditimit

Çështja B1 - Klasifikimi jo adekuat i shpenzimeve

Gjetja Neni 18 i pikës 3 të Rregullës Financiare Nr. 01/2013 Shpenzimi i parave publike, përcakton që shpenzimet duhet të kenë kodet adekuate, të përcaktuara me planin kontabël. Gjithashtu, me planin kontabël të SIMFK-së janë përcaktuar saktë kategoritë ekonomike të shpenzimeve dhe kodet përkatëse prej nga duhet të realizohen pagesat e shpenzimeve sipas secilit lloj.

Përmes vendimeve gjyqësore përmbarimore, ishin ekzekutuar pagesa në vlerë 626,785€, për mbulimin e obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive për paga jubilarë dhe shujta. Nga kjo vlerë 323,479€, ishin ekzekutuar nga kategoria e investimeve kapitale 242,306€, nga mallrat dhe shërbimet si dhe 61,000€, nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mosfunksionimit të mirë të kontrolleve të brendshme në planifikimin e buxhetit për shpenzimet që rrjedhin nga kontrata kolektive.

Ndikimi Regjistrimi dhe pagesa e shpenzimeve nga buxheti i kategorive ekonomike jo adekuate pamundëson raportim të drejtë dhe të saktë të informacionit financiar të shpenzimeve në PVF. Shfrytëzimi i buxhetit të kategorive tjera për pagesën e shpenzimeve që i takojnë pagave dhe mëditjeve, ka reflektim negativ duke vështirësuar apo edhe pamundësuar realizimin e objektivave të komunës.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë planifikime të mirëfillta buxhetore sipas natyrës së shpenzimeve, apo të bëhet ridestinimi i mjeteve, ashtu që shpenzimet të paguhen dhe regjistrohen nga buxheti i kategorive përkatëse, në përputhje me planin kontabël të thesarit, për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PVF.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B2 - Mos regjistrim i pasurive nën 1,000€ në sistemin e-pasurisë dhe humbje e pasurive

Gjetja Neni 6.3 i Rregullores MF-nr.02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, përcakton se, pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin "e-pasuria". Po ashtu, neni 9 paragrafi 10 i rregullores së njëjtë, specifikon se për të gjitha vendimet e marra, komisioni për tjetërsimin e pasurisë jo financiare do të njoftojë zyrtarin e pasurive dhe do t'i dorëzojë një kopje të të gjithë dokumentacionit lidhur me procesin e tjetërsimit.

Në tre (3) raste në vlerë 24,543€, pasuri jo kapitale të teknologjisë informative të blera gjatë vitit 2024 nuk ishin regjistruar në sistemin "e-pasuria", duke e nënvlerësuar regjistrin e pasurive në raportin vjetor financiar për këtë shumë. Po ashtu, me rastin e verifikimit të ekzistencës së pasurive jo financiare, kemi identifikuar se tre vetura me vlerë fillestare totale 25,800€ (vlera neto në libra, zero), të cilat ende figurojnë në regjistrin kontabël të pasurive të komunës, nuk ekzistonin fizikisht. Këto vetura ishin blerë njëra në vitin 2006, e dy të tjera në vitin 2013, derisa më tutje, komuna nuk ka dokumentacion që lidhet me procesin e shitjes, tjetërsimit apo dhurimit të këtyre veturave.

Kjo ka ndodhur si rezultat i mungesës së kontrolleve të brendshme për regjistrimin dhe menaxhimin e pasurive.

Ndikimi Mos regjistrimi i plotë i pasurive jo kapitale si dhe pa mundësia për të dëshmuar ekzistencën fizike të pasurive që janë në regjistra rritë mundësinë e keqpërdorimit të pasurisë, humbjes apo tjetërsimit. E gjithë kjo, ndikon në raportimin jo të saktë dhe jo të drejtë të pasurive në raportin vjetor financiar të komunës.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtarët e pasurive regjistrojnë pasuritë jo kapitale në regjistra kontabël, ashtu që pasuritë të raportohen saktë dhe të plota në raportin vjetor financiar. Po ashtu, të gjitha pasuritë e mbajtura në regjistra duhet të jenë të mbështetura me dokumentacion dhe ekzistencë fizike, në mënyrë që të evitohet mundësia e humbjes apo keqpërdorimit të pasurisë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Çështja A1 - Shfrytëzimi i pronave komunale pa kontratë

Gjetja Sipas Ligjit nr. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 23 përcakton: 1. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona i kthehet komunës.

Në dy (2) raste të shfrytëzimit të pronës komunale, kontratat për shfrytëzimin e këtyre pronave kishin skaduar në vitin 2007, përkatësisht 2010, megjithatë, ato vazhdonin të ishin në përdorim dhe të faturoheshin nga komuna. Shfrytëzuesit e këtyre pronave kishin obligime të pa paguara të qirasë ndaj komunës në vlerë 25,800€.

Kjo ka ndodhur për shkak të mungesës së kontrolleve të brendshme për të formalizuar procesin e kontraktimit të pronave të dhëna me qira.

Ndikimi Shfrytëzimi i pronave komunale në mungesë të kontratave shkakton paqartësi për kushtet kontraktuale në mes komunës dhe shfrytëzuesve të pronave publike, por edhe vështirësi në inkasimin e të hyrave nga qiraja. Gjithashtu, kjo mund të rezultojë edhe me keqpërdorime të pronës nga ana e qiramarrësve.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që, pas përfundimit të afatit të caktuar në kontratën për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, prona t'i kthehet komunës, apo kontratat të vazhdojnë bazuar në çmimet e tregut, sipas procedurave përkatëse për dhënien në shfrytëzim të pronave komunale.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja A2 - Mangësi në procedurat e dhënies së subvencioneve

Gjetja Neni 20 pika 3.3 i Rregullores MF 04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve thekson se, në fazën e përfundimit të vlerësimeve dhe publikimi i rezultateve, komisioni vlerësues kërkon nga aplikuesit e përzgjedhur në listën e rezultateve paraprake dokumentacionin përkatës ku përfshihet edhe dëshmia se OJQ-ja aplikuese nuk është në procedurë të shuarjes dhe ç 'regjistrimit.

Në dy raste të subvencionimit të OJQ-ve në vlerë 6,800€, komuna kishte ndarë subvencione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit, për përfituesit të cilët nuk i kishin përmbushur kriteret e kërkuara me rregulloren përkatëse, pasi që u mungonte vërtetimi nga gjykata si dëshmi se ata nuk janë në procedurë të shuarjes dhe ç 'regjistrimit, e cila kërkohej me rregulloren përkatëse për subvencionim të OJQ-ve.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme dhe mungesës së përgjegjësisë për zbatimin e kërkesave ligjore lidhur me subvencionimin e OJQ-ve.

Ndikimi Përzgjedhja e përfituesve që nuk i plotësojnë kërkesat e rregullores përkatëse ndikon në mos transparencën e procesit dhe rritë rrezikun që fondet të mos shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe qëllimi i subvencionimit mos të arrihet.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se me rastin e subvencionimit, do të përfitojnë vetëm OJQ-të që i plotësojnë kriteret e rregullores për subvencionim, ashtu që mjetet të shfrytëzohen në mënyrë efektive dhe të arrihet qëllimi i subvencionimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

Çështja B3 - Vonesa në pagesën e faturave

Gjetja Neni 39.1 i LMFPF përcakton se ZKF i organizatës buxhetore është përgjegjës për të siguruar që çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim për mallra dhe shërbimet e furnizuara dhe/ose punët e realizuara për organizatën buxhetore të paguhen brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike pas pranimit të faturës ose kërkesës për pagim nga organizata përkatëse buxhetore.

Në tre (3) raste, faturat në total prej 127,675€ nuk janë paguar në afatin e paraparë ligjor. Vonesat në ekzekutimin e pagesave janë deri në 30 ditë pas afatit të lejuar për pagesë.

Kjo kishte ndodhur për shkak hyrjes në obligime financiare pa pasur fonde buxhetore të planifikuara dhe mangësive në menaxhimin e obligimeve

Ndikimi Tejkalmi i afatit ligjor për pagesën e faturave mund ta bëjë komunën subjekt të padive nga operatorët ekonomik, duke shkaktuar shpenzime shtesë gjyqësore/përmbartimore apo obligime për vitin vijues.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të përmirësojë menaxhimin e fondeve për të siguruar që obligimet financiare kryhen brenda afatit prej 30 ditëve, duke përfshirë hartimin e një analize të hollësishme buxhetore për të shmangur vonesat në pagesat e faturave.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.3.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 4,593,987€, prej tyre ishin shpenzuar 3,886,479€ apo 85% Ato kanë të bëjnë me: ndërtimin e rrugëve lokale, ujësjellësve, kanalizimeve, trotuareve etj.

Çështja A3 - Vonesa në realizimin e projekteve

Gjetja

Sipas nenit 70.23 të Rregullave 001-2022 për prokurimin publik, menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuara në kontratë. Në kontratat e lidhura ndërmjet komunës dhe operatorëve ekonomik, janë përcaktuar afatet kohore të realizimit të kontratave.

Në tre (3) raste, kemi evidentuar vonesa në realizimin e projekteve, si në vijim:

- Kontrata për projektin “Ndërtimi i sistemit të ri të ujësjellësit, gjelbërimit dhe ndriçimit në qendër të Istogut” në vlerë 229,304€, e nënshkruar më 23.12.2022, sipas kushteve të parapara me planin dinamik do të duhej të përfundonte më 22.12.2023, mirëpo pranimi teknik për këtë projekt ishte bërë më 06.09.2024, duke rezultuar me nëntë muaj vonesë në realizim të punëve;
- Kontrata për projektin “Ndërtimi i rrugëve lokale / kanalizimit në Muzhevinë” në vlerë 173,174€, e nënshkruar më 14.11.2023, sipas kushteve të parapara me planin dinamik do të duhej të përfundonte më 15.01.2024, mirëpo pranimi teknik për këtë projekt ishte bërë më 16.04.2024, duke rezultuar me tre muaj vonesë në realizim të punëve; dhe
- Kontrata për projektin “Ndërtimi i rrugës Idriz Nekaj në Shushicë” në vlerë prej 183,206€, e nënshkruar më 30.11.2022, sipas kushteve të parapara me planin dinamik do të duhej të përfundonte më 30.04.2024, deri sa ishte punimet ishin pranuar nga komisioni më datën 29.07.2024, duke rezultuar me tre muaj vonesë në realizim të punëve.

Shkak i vonesave ishte mungesa e mjeteve në dispozicion për të përfunduar kontratën si pasojë e planifikimit jo të duhur të projekteve, si dhe problemet tjera në shpronësimin e pronave. Këto vonesa ishin arsyetuar nga menaxherët e kontratave përkatëse.

Ndikimi

Vonesat në kryerjen e projekteve ndikojnë në rritjen e obligimeve kontraktuese të cilat mund të kenë implikime buxhetore për buxhetin e vitit pasues. Kjo po ashtu, ndikon në mos arritjen e objektivave të përcaktuara të Komunës dhe pamundësinë e shfrytëzimit të këtyre projekteve të cilat janë në shërbim të qytetarëve të komunës.

Rekomandimi A3

Kryetari duhet të siguroj se para inicimit të projekteve për punë, të përmbushen kushtet e realizimit projektit në aspektin teknik, përmes hartimit të mirëfilltë të projekteve, në mënyrë që punët të realizohen sipas planit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)**Çështja C1 - Mungesë e informatave të plota për menaxhimin e kontratave përmes platformës elektronike****Gjetja**

Sipas nenit 70.2 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurimin Publik: “Vlerësimi i performancës së kontraktuesve do të bëhet: i) në sistem të prokurimit elektronik nëpërmjet modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve; ii) nga menaxherët e kontratës dhe mbikqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, dhe iii) në pajtim me manualët për përdorim të modulit për vlerësim të performancës së kontraktuesve”. Më tutje, sipas nenit 70.24: “Menaxheri i kontratës të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, mbahen dhe arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës në sistem të prokurimit elektronik”.

Në shtatë (7) ¹ kontrata, menaxherët e kontratave/projekteve nuk kanë mbajtur dhe arkivuar me informata të plota menaxhimin e kontratave dhe vlerësimin e performancës së kontraktuesve në modulin përkatës në sistemin elektronik të prokurimit publik.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i moskryerjes së punës me përgjegjësi nga ana e menaxherëve të kontratave dhe mbikëqyrësve të drejtpërdrejtë të tyre.

Ndikimi

Mungesa e plotë e të dhënave të menaxhimit të kontratave përmes sistemit të prokurimit publik, mund të ndikoj në një menaxhim jo të mirëfilltë dhe transparent të kontratave, si dhe nuk ofron mundësi të mjaftueshme që menaxhmenti të merr informata me kohë në lidhje me progresin dhe performancën e kontratave.

Rekomandimi C1

Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave mbajnë të dhënat e plota për menaxhimin e kontratave në modulin përkatës në sistemin e prokurimit publik dhe vlerësimin e performancës sipas rregullave përkatëse.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e paraqitur në PFV e pasurive kapitale është 123,390,929€, pasurive jokapitale 557,939€ si dhe stoqeve 72,788€.

Çështja A4 - Mos mbyllja e investimeve në vijim si dhe regjistrimi i tyre si pasurive në përdorim

Gjetja Rregullorja 02/2013 për Menaxhimin e Pasurive të Organizatave buxhetore, përcakton mënyrën e regjistrimit, mirëmbajtjes së regjistrave të pasurive, zhvlerësimin, procesin e inventarizimit, po ashtu sipas nenit 11 thuhet se pas përfundimit të procesit të investimit pasuria jo financiare kapitale do të klasifikohet si pasuri jo financiare në përdorim. Nga momenti i aftësimit të pasurisë për përdorim do të zbatohet edhe zvlerësimi.

Gjatë testimit të pasurive kemi vërejtur se në shtatë (7) raste të pasurive të regjistruara si "Investime në vijim", të njëjtat janë në përdorim por nuk janë pranuar teknikisht. Këto pasuri figuronin në regjistër si investime në vijim, edhe pse të njëjtat shfrytëzohen nga komuna dhe do të duhej të regjistroheshin si pasuri në përdorim dhe për to të kalkulohej zhvlerësimi. Në pamundësi të sigurimit të informatave të sakta për kohën e funksionalizimit të këtyre pasurive, ne nuk kemi mundur të kalkulojmë vlerën e gabimit të zhvlerësimit, përkatësisht vlerën e mbivlerësimit të pasurisë në PFV.

Kjo kishte ndodhur për shkak të mosfunksionimit të kontrolleve të brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare ndër vite.

Ndikimi Mungesa e pranimi teknik për pasuritë e përfunduara që janë në përdorim nga komuna ndikon në paqartësinë e statusit të tyre duke shkaktuar vlerësim jo të drejtë dhe raportim të pa saktë të tyre.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të forcojë kontrollet e brendshme në menaxhimin e pasurive jo financiare, duke siguruar pranimin teknik të projekteve të përfunduara dhe regjistrimin e tyre si pasuri në përdorim në mënyrë që të njëjtat të raportohen drejtë dhe saktë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.3 Të arkëtueshmet

Komuna në vitin 2024 ka shpalosur në PVF llogaritë e arkëtueshme në vlerë 1,550,721€. Këto kishin të bënin me tatimin në pronë 1,271,215€, ngarkesat për afarizëm dhe biznes në vlerë 174,831€ dhe të tjera në vlerë 104,675€.

Çështja B4 - Menaxhimi jo efikas i llogarive të arkëtueshme

Gjetja

Sipas nenit 27.1. nëse një tatimpagues apo debitor nuk ka paguar plotësisht tatimin dhe gjobën nëse ka të këtillë, ose detyrimet tatimore të papaguara, në përputhje me afatet e përcaktuara, komuna nxjerr njoftimin përfundimtar me shkrim brenda dhjetë (10) ditëve pune pas ditës së fundit për pagesë, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimeve tatimore të papaguara, jo më vonë se dhjetë (10) ditë kalendarike pas ditës që njoftimi përfundimtar konsiderohet të jetë pranuar nga debitori. Gjithashtu sipas Ligjit Nr. 03/L-049 për Financat e Pushtetit Lokal, komunat janë përgjegjëse për mbledhjen e të hyrave vetanake dhe duhet të kenë sisteme të përshtatshme për të siguruar regjistrimin, monitorimin dhe inkasimin e të gjitha të hyrave komunale.

Më tutje, sipas kontratave për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale, qiraja mujore do të paguhet në fillim të çdo muaji e më së voni deri më datën pesë (5) të muajit vijues.

Në pasqyrat financiare janë shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 1,550,721€. Pjesa më e madhe e këtyre llogarive i takon tatimit në pronë, me vlerë prej 1,271,215€ (rreth 82%), taksës komunale për biznese me vlerë 174,831€ (rreth 11%), qirasë për shfrytëzimin e pronës komunale me vlerë 54,411€ (rreth 3%), taksës për leje ndërtimi me vlerë 42,324€ (rreth 3%), dhe të tjera në vlerë 7,940€ (rreth 1%).

Në tre (3) raste në vlerë 15,710€, të llogarive të arkëtueshme nga tatimi në pronë, në dy (2) raste në vlerë 25,800€, të llogarive të arkëtueshme nga shfrytëzimi i hapësirës publike, dhe në një (1) rast në vlerë 3,305€, të llogarive të arkëtueshme nga taksat për leje ndërtimi, komuna nuk kishte ndërmarrë veprime ligjore përmes përmbarduesit për mbledhjen e këtyre borxheve, edhe pse ishin tejkaluar afatet e përcaktuara në kontratë dhe afatet në shkresat për rikujtimin e borxheve. Kjo ka ndikuar në rritjen e llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin paraprak për 39,249€.

Kjo ka ndodhur për shkak të kontrolleve dhe veprimeve të pamjaftueshme ligjore në arkëtimin e të hyrave sipas afateve.

Ndikimi

Mos arkëtimi në kohë i të hyrave ka ndikim negativ në nivelin e buxhetit, pasi krijon mungesë fondesh të mbledhura, duke penguar financimin dhe realizimin e projekteve komunale. Gjithashtu, kjo çon në vjetërsimin e këtyre llogarive, duke e bërë të pamundur arkëtimin e tyre.

Rekomandimi B4

Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore me qëllim të rritjes së efikasitetit në arkëtimin e të hyrave me kohë.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

2.3.4 Funksioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me vetëm një Auditor (Drejtorin e NjAB-së). NjAB kishte hartuar planin strategjik dhe planin vjetor të punës. Gjatë vitit 2024, kjo njësi nuk e kishte përfunduar asnjë auditim. Komiteti i Auditimit (KA), gjatë vitit 2024 kishte mbajtur vetëm një takim.

Çështja B5 - Dobësi në punën e Njesisë së Auditimit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit

Gjetja

Neni 5.1.1 i Rregullores QRK-nr. 01/2019 për themelimin dhe zbatimin e funksionit të auditimit të brendshëm në subjektin e sektorit publik, përcakton që çdo subjekt i sektorit publik me buxhet mbi shtatë (7) milion euro duhet të ketë së paku tre auditorë. Po ashtu, Plani vjetor i auditimit të NjAB për vitin 2024, parashihte kryerjen e katër auditimeve përgjatë vitit. Më tutje, Udhëzimi Administrativ MF-nr. 01/2019 për themelimin dhe funksionimin e komitetit të auditimit në subjektin e sektorit publik, neni 6, specifikon se, Komiteti i Auditimit emërohet nga udhëheqësi i subjektit të sektorit publik dhe përbëhet nga tre (3) ose pesë (5) anëtarë, ndërsa neni 8 specifikon se, takimet e Komitetit të Auditimit mbahen së paku katër (4) herë në vit dhe ftohen nga kryesuesi i Komitetit të Auditimit.

Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk është e plotësuar me staf sipas kërkesave ligjore, pasi që e njëjta përbëhet vetëm nga një auditor, që është edhe udhëheqës i NjAB-së (ushtrues detyre).

Për më shumë, Udhëheqësi i NjAB-së i cili ka ushtruar këtë pozitë gjatë gjithë vitit, nuk kishte realizuar asnjë auditim nga katër (4) auditimet e planifikuara për vitin 2024.

Më tutje, Komiteti i Auditimit (KA) i themeluar në vitin 2022 me vendim të Kryetarit përbëhej vetëm nga dy (2) anëtarë, duke anashkaluar kërkesat e udhëzimit për përbërje prej tre (3) ose pesë (5) anëtarëve. Gjithashtu, KA gjatë vitit 2024 kishte mbajtur vetëm një takim, në vend të katër (4) takimeve të obligueshme që parashikon udhëzimi.

Mosplotësimi i stafit të NjAB dhe KA kishte ndodhur për shkak të mungesës së veprimeve të mjaftueshme të menaxhmentit për zbatim të kërkesave të rregullores përkatëse. Përderisa, moskryerja e auditimeve të planifikuara nga NjAB ka rezultuar nga mungesa e përgjegjësisë së udhëheqësit për realizimin e planit të auditimit, mungesa e mbikëqyrjes nga KA, si dhe për shkak të mungesës së vullnetit të menaxhmentit për krijimin e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm.

Ndikimi

Mangësitë e identifikuar në funksionimin e NjAB dhe KA kanë pamundësuar parandalimin e mangësive në kontrollet e brendshme dhe maksimizimin e përfitimit të komunës nga puna e NjAB-së dhe KA në krijimin e një sistemi efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Rekomandimi B5

Kryetari duhet të sigurojë që NjAB dhe KA të plotësohet me staf të nevojshëm, sipas kërkesave ligjore. Po ashtu, duhet të sigurohet për realizimin e auditimeve të parapara me planin vjetor të auditimit të NjAB-së dhe funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit.

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Pajtohen)

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁶	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Burimet e fondeve	15,141,743	16,672,895	15,872,565	14,692,547	11,589,771
Grante Qeveritare - Buxheti	13,690,716	14,391,514	13,970,835	13,009,403	9,897,405
Financimi përmes huamarrjes	0	0	0	0	98,602
Financimi përmes huamarrjes - klauzola e investimeve	144,804	144,804	0	0	0
Të bartura nga viti i kaluar	0	528,369	440,085	521,746	616,338
Të hyrat vetanake	1,306,223	1,507,053	1,379,642	1,103,098	945,931
Donacionet vendore	0	101,152	82,004	45,876	31,495
Donacionet e jashtme	0	3	0	12,424	0

Buxheti final është më i lartë se buxheti fillestar për 1,531,152€, kjo rritje është rezultat i rritjes nga granti qeveritar në bazë të vendimit të qeverisë për 700,798€, të hyrave të bartura nga viti paraprak 528,369€, rritjes së të hyrave vetanake për vitin 2024 në vlerë 200,830€ dhe donacioneve 101,155€.


Në vitin 2024 Komuna ka shpenzuar 95% të buxhetit final ose 15,872,565€, me ulje prej 1% krahasuar me vitin e kaluar (2023 - 96%). Realizimi i buxhetit është në nivel të kënaqshëm dhe shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Shpenzimet	2023 Shpenzimet	2022 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	15,141,743	16,672,895	15,872,565	14,692,547	11,589,771
Pagat dhe mëditjet	7,982,237	8,773,812	8,772,730	8,088,978	6,638,555
Mallrat dhe shërbimet	2,435,230	2,545,242	2,475,628	1,896,275	1,829,768
Komunalitë	232,000	262,000	259,149	198,874	188,599
Subvencionet dhe transferet	382,000	497,854	478,580	478,413	347,736
Investimet Kapitale	4,110,276	4,593,988	3,886,479	4,030,006	2,585,113

- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar tek kategoria pagave dhe mëditjeve ishte rritur për 791,575€. Rritja ishte nga granti qeveritar bazuar në vendimet e Qeverisë për mbulim të obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve ishte rritur për 110,012€. Realizimi i buxhetit final në këtë kategori ishte 97%. Realizimi i kësaj kategorie ishte ndikuar edhe nga pagesat përmes vendimeve gjyqësore të pagave jubilarë në vlerë 242,306€;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për shpenzime komunale ishte rritur për 30,000€, përderisa realizimi ishte 99% e buxhetit final;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për subvencione dhe transfere ishte rritur për 115,854€, përderisa realizimi ishte në shkallën prej 96% e buxhetit final. Realizimi i kësaj kategorie ishte ndikuar edhe nga pagesat përmes vendimeve gjyqësore të pagave jubilarë në vlerë 61,000€; dhe
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar në kategorinë e investimeve kapitale ishte rritur për 483,711€, ndërsa realizimi ishte 85% e buxhetit për shkak se disa projekte kishin mbetur pa realizuar si rezultat i vendimeve gjyqësore. Realizimi i kësaj kategorie ishte ndikuar edhe nga pagesat përmes vendimeve gjyqësore të pagave jubilarë në vlerë 323,479€.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2024



Të hyrat e planifikuara për vitin 2024 ishin 1,306,223€, ndërsa janë realizuar 1,927,367€, duke tejkaluar planin për 48%. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, lejet mjedisore, taksat administrative, participimet, të hyrat nga qiraja etj.

Gjithashtu, në vitin 2024 Komuna e Istogut ka përfituar të hyra nga gjrobat në trafik dhe gjykatave në vlerë 299,324€ si dhe të hyrat nga Agjencioni i pyjeve në vlerë prej 15,019€. Këto të hyra nuk janë të përfshira në tabelën e mëposhtme pasi që të njëjtat i planifikon dhe realizon Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa komunës i alokohen për shpenzime.

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2024 Pranimet	2023 Pranimet	2022 Pranimet
Totali i të hyrave	1,306,223	1,306,223	1,927,367	1,339,018	1,079,823
Të hyrat tatimore	655,268	655,268	492,113	589,605	422,826
Të hyrat jo tatimore	650,955	650,955	1,435,254	749,413	656,667
Të hyrat tjera	0	0			330

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti i auditimit për PVF-të e vitit 2023 për Komunën e Istogut ka rezultuar me nëntë (9) rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna. Raporti i auditimit për vitin 2023 si dhe plani i veprimit për adresimin e rekomandimeve është diskutuar në Kuvendin Komunal të Istogut.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2024, pesë rekomandime nuk janë zbatuar, një rekomandim ishte zbatuar, një rekomandim i zbatuar pjesërisht dhe dy rekomandime nuk janë të aplikueshme më, siç është paraqitur në Grafikon 2, më poshtë. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën e rekomandimeve nr. 4.

Grafiku 2. Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak




Tabela 4. Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2023	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë se respektohen hapat e përcaktuar me rregullat në fuqi për procedimin e pagesave nga zyrtarët përgjegjës, në mënyrë që fillimisht të bëhet zotimi i mjeteve, të nxjerrët urdhër blerja dhe më pas pranimi i mallrave/punëve.	Për shkak të rëndësisë dhe natyrës së këtyre shpenzimeve rekomandimi është mbyllur.	Nuk është i aplikueshëm më

2.	Baza për konkluzion	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e kontrolleve në fushën e dhënies dhe monitorimit të subvencioneve, në mënyrë që mjetet fondet e dhëna nga komuna të shfrytëzohen vetëm për qëllimet e subvencionuara. Nëse përfituesit nuk arrijnë të arsyetojnë shfrytëzimin e mjeteve fondeve në përputhje me qëllimin e dhënë, të merren masa për kthimin e mjeteve fondeve nga përfituesit	Janë ndërmarrë veprime të nevojshme dhe kjo çështje nuk ka rezultuar në vitin 2024.	I zbatuar
3.	Pasqyrat Financiare Vjetore	Kryetari duhet të sigurojë që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestinimi i mjeteve që pagesa dhe regjistrimi i shpenzimeve më pas të bëhet sipas kodeve ekonomike adekuate.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
4.	Investimet kapitale	Kryetari duhet të kërkojë nga të gjithë menaxherët e projekteve për tu siguruar që menaxhimi i kontratave do të mbahet dhe arkivohet nga sistemi elektronik i prokurimit publik.	Raporti i monitorimit ishte plotësuar pjesërisht pasi situacionet e pranuar nuk ishin regjistruar sipas formës së kërkuar.	Pjesërisht i zbatuar
5.	Pasuritë	Kryetari duhet të shtojë kontrollet e brendshme për tu siguruar se zyrtarët e pasurive do ta regjistrojnë pasurinë jo kapitale në regjistra kontabël përkatësisht në sistemin e-pasurisë.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
6.	Llogaritë e arkëtueshme	Kryetari duhet të sigurojë forcimin e mekanizmave të kontrollit në mbledhjen e borxheve nga tatimpaguesit, duke i shfrytëzuar të gjitha mjetet në dispozicion, pa përjashtuar edhe veprimet ligjore.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
7.	Obligimet e papaguara	Kryetari duhet të sigurojë një planifikim më të mirë të fondeve buxhetore, si dhe iniciimi i procedurave të shpenzimeve të realizohet vetëm kur fondet janë në dispozicion me qëllim të eliminimit të vonesave për pagesat e faturave apo të shmangies së padive eventuale nga operatorët ekonomik.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimin
8.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë funksionimin efektiv të Komitetit të Auditimit, në mënyrë që të rishikojë planet e auditimit të brendshëm, për të konfirmuar se ato bazohen në rrezik dhe t'i ofrojë sigurinë e kërkuar menaxhmentit për funksionimin e kontrolleve të brendshme.	E gjetura e KA është fuzionuar tek e gjetura e NjAB, pasi që janë bashkuar gjetjet.	Nuk është i aplikueshëm më

9.	Auditimi i Brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë, dhe që NjAB të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores për themelimin e saj, e që njëkohsisht do të rriste dhe forconte kontrollet e brendshme.	Kjo çështje është reflektuar edhe në vitin 2024, pasi që nuk ishin ndërmarrë veprime të nevojshme.	Nuk ka filluar zbatimi
----	----------------------	---	--	------------------------

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Florim Maliqi, Udhëheqës i ekipit



Astrit Bllaca, Anëtar i ekipit



Lumni Mazreku, Anëtar i ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi



Komuna e Istogut
Opština Istok
Istog Municipality

LETËR E KONFIRMIMIT

01. Nr. 516/2025

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Istogut, për vitin 2024 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

z. Ilir Ferati

Kryetar i Komunës së Istogut,

Data: 09.06.2025, Istog



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁷ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁸, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionit i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionit

Opinionit i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinion i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjera", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁴ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja
Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura
Çështja C dhe Rekomandimi C- nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.
- ⁵ 1.Ndërtimi i rrugës Idriz Nekaj në Shushicë të ulët. 2. Ndërtimi i sallës së sporteve në Vrellë - vazhdim 3. Ndërtimi i kanalizimit në Muzhevinë si dhe ndërtimi i rrugës Arif Pepaj
- ⁶ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁷ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁸ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.